



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**AC-II.-12–0109**

Në çështjen juridike të,

**A.G.** nga Prizreni

**Paditësja**

**NSH-** Prizren, i përfaqësuar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit(AK), rr. “Agim Ramadani” nr. 23 Prishtinë.

**E paditura/ankuesja**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Sabri Halili, gjyqtar kryesues, Mr.sc Sahit Sylejmani dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës të paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr.318/2006 të datës 18 janar 2010, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 15 gusht 2019, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e AKP-së refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr.318/2006 i datës 18 janar 2010.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 24 prill 2006, paditësja kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale të Prizrenit, me të cilën kërkonte dorëzimin e pronësisë, ngastrës kadastrale nr. 7065/1 sipas Fletës poseduese nr. 6185 ZK Prizren.

## II

Më 26 janar 2007, paditësja kishte parashtruar një padi në Dhomën e Posacme me të cilën kërkonte kthimin e pronës së paluajtshme, ngastrën kadastrale nr. 7065/1, e regjistruar në listën poseduese nr. 6185 ZK Prizren. Paditësja pretendon se paraardhësi i saj ishte pronar i kësaj prone, por edhe vetë paditësja është pronare në bazë të vendimit të Gjykatës Komonale të Prizrenit të datës 24 nëntor 2004, që në procedurë jokontestimore e ka shpallur paditësen si pronare të pronës në fjalë.

Me Aktvendimin SCC-07-0035 të datës 28 shkurt 2007 Dhoma e Posacme këtë padi e referoi për gjykim në Gjykatën Komonale të Prizrenit.

Me Aktgjykimin C.nr.318/06, të datës 18 janar 2010, Gjykata Komonale në Prizren kishte aprovuar pjesërisht padinë e paditëses dhe e kishte obliguar të paditurën që t'ia dorëzoj në posedim pjesën e ngastrës kadastrale nr. 7065/1 në sipërfaqe prej 0.13,18 ha, e evidentuar në Fletën Poseduese nr. 11566 Z.K Prizren në kufinjët si në vijim: nga veriu 39,86 m, nga jugu 37,63 m, nga lindja 22,03 m dhe nga perëndimi 45,91 m dhe e paditura është e obliguar që t'ia njoh këtë të drejtë. Padia ndaj të paditurës së parë KBI ishte tërhequr.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi Gjykata Komonale theksonte se me administrimin e povave në shkresat e lëndës, gjegjësisht me Vendimin e Gjykatës Komonale O. Nr. 134/04 të datës 24 nëntor 2004, listën poseduese nr. 11566 dhe provave tjera kishte ardhë në përfundim se ngastra kadastrale nr. 7065/1 në sipërfaqe prej 0.27,18 ha në bazë të ndryshimeve nga viti 1953, ishte e evidentuar në emër të babait të paditësit në listën poseduese nr. 6158 ZK Prizren. Në bazë të Vendimit mbi trashëgiminë, nga viti 2004, kjo ngastër ka kaluar në emër të A.Sh. e lindur G, vajza e tani të ndjerit F.G.. Edhe aktualisht kjo pronë evidentohet në emër të A.Sh.G. Pas daljes së ekspertit gjeodet në vendin e ngjarjes, është vërtetuar se nga ngastra kadastrale nr. 7065 ZK Prizren në sipërfaqe prej 0.13,18 ha që kërkohet me padi, është e lirë, nuk ka ndërtime të objekteve ndërtimore dhe se mundet pa u penguar t'i dorëzohet në posedim pronaresë-paditëses. Në anën tjetër, e paditura nuk ka ofruar asnjë provë materiale për të dëshmuar të kundërtën kështu që pretendimet e tij gjykata i ka refuzuar si të pabazuara.

Më 07 korrik 2008 AKP kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi për shkak të të gjitha arsyeve ankimore. Sipas AKP-së, Gjykata e Prizrenit këtë aktgjykim e ka mbështetur në prova të vjetruara dhe përmend Vërtetimin e Drejtorisë për Punë Pronësore Juridike të datës 22 dhjetor 1989, e kjo, sipas AKP-së nuk vërteton se pas këtij viti nuk ka pasur ndonjë ndryshim në aspektin juridiko pronësor lidhur me ngastrën kontestuese. Në këtë ankesë, AKP thekson se e paditura këtë pronë e mban në posedim nga viti 1961, dhe ngjit dyshimin se në çfarë baze juridike është bërë pronar paraardhësi i paditësve. AKP pretendon se ngastra kontestuese është në kuadër të kompleksit të Fabrikës dhe nse dorëzimi në

### III

posedim të paditësit të kësaj ngastre do të ndikoj drejtpërdrejt në veprimtarinë dhe vlerën e kësaj ndërmarrje, e cila duhet t'i nënshtrohet procesit të privatizimit. AKP konsideron se ekspertiza në të cilën mbështetet aktgjykimi i kundërshtuar është e mangët, sepse nuk qartëson bazën juridike se si pararadhësi i paditësve është bërë pronar i pronës kontestuese dhe si të tillë këtë aktgjykim AKP nuk mund ta pranoj. AKP pretendon se në bazë të nenit 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar, afati për mundësinë e kërimit të kësaj të drejte ishte 5 vjet nga data e marrjes në dijeni, por jo më vonë se 10 vjet dhe kjo e drejtë më nuk mund të kërkohej.

Për këto arsye, AKP propozon që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Në përgjigjen ndaj ankesës paditësi i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore si të pabazuara dhe propozon që si e tillë ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

#### **Arsyetimi Ligjor**

Ankesa është e pabazuar.

Në bazë të nenit 9.9 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) dhe nenit 69.1 të këtij ligji, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Apelit pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore të AKP-së, aktgjykimin e ankimuar dhe provat në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se ankesa është e pabazuar.

Gjykata Komunale në Prizren, me aktgjykimin e ankimuar e kishte aprovuar kërkesë padinë e paditëses dhe e kishte obliguar të paditurën që ta ta njoh këtë të drejtë dhe t'ia dorëzoj paditëses në posedim pronësinë kontestuese. Ky aktgjykim mbështetej në provat e parashtruara në shkresat e lëndës si, Vendimi i Gjykatës Komunale O.nr. 134/04 të datës 24 nëntor 2004, listën poseduese nr. 11566 dhe ekspertizës së ekspertit gjeodet, kishte ardhë në përfundim se ngastra kadastrale nr. 7065/1 në sipërfaqe prej 0.27,18 ha në bazë të ndryshimeve nga viti 1953, ishte e evidentuar në emër të babait të paditësit në listën poseduese nr. 6158 ZK Prizren. Është vërtetuar se ngastra kadastrale nr. 7065 ZK Prizren në sipërfaqe prej 0.13,18 ha që kërkohej me padi, është e lirë, nuk ka ndërtime të objekteve ndërtimore dhe se mundet pa u penguar t'i dorëzohet në posedim pronares-paditëses. Në anën tjetër, e paditura nuk ka ofruar asnjë provë materiale për të dëshmuar të kundërtën kështu që pretendimet e të paditurës gjykata i ka refuzuar si të pabazuara.

Me gjetjet dhe konstatimet e Gjykatës Komunale të Prizrenit pajtohet edhe Kolegji i Apelit në tërësi. Pretendimet ankimore të AKP-së nuk janë të bazuara në fakte relevante dhe prova materiale. AKP pos konstatimeve të pambështetura dhe pyetjeve se në çfarë baze juridike është bërë pronar paraardhësi i paditësve, nuk ofron asnjë provë apo fakt që do të mund të vërtetohej e kundërta e asaj që është vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prizren.

As pretendimi ankimor i AKP-së se në bazë të nenit 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar, kjo e drejtë më nuk mund të kërkohet, nuk është i saktë, sepse e drejta sendore është e drejtë absolute dhe si e tillë asnjëherë nuk parashkruhet.

Për më tepër, në bazë të provave në shkresat e lëndës, kjo pronë asnjëherë nuk ishte në emër të NSH-së.

Për të gjitha arsyet e lartëcekura Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e AKP-së është e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe si i tillë duhet të vërtetohet.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së u vendos si në dispozitivtë këtij aktgjykimi.

#### **Shpenzimet/Taksat gjyqësore**

Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27 mars 2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive në lëndët në pritje.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit më 15 gusht 2019.

Sabri Halili, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_

**URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT**

Luteni të dërgoni këtë Aktgjykim tek:

- Palët,
- Gjykatën Themelore në Prizren në lëndën nr. C.nr.318/2006.

Sabri Halili, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_